



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 2181 Prot.
Datë: 28.01.2020

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 09.01.2020

VENDIM

Nr. 32, datë 9.01.2020

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE
"BACHELOR NË MATEMATIKË"**

Mbështetur në shkronjën d të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën dh të pikës 1 në nenin 19 në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020


VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e programit të ciklit të parë të studimeve "Bachelor në matematikë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

RREGULLORE

**E PROGRAMIT MËSIMOR TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR NË
MATEMATIKË"**

VLORE 2019





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**Neni 1
HARTIMI DHE PËRMBAJTJA E RREGULLORES**

Kjo rregullore është hartuar nga Departamenti i Matematikës dhe mbështetet në:

- i. *Ligji nr 80/2015 "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"*
- ii. *STATUTI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE, 2013*
- iii. *RREGULLORE E BRENDSHME të UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE, 2014*
- iv. *VENDIMET E SENATIT të UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE*
- v. *RREGULLORE, URDHËRA DHE VENDIME TË DEKANATIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE*

1. Rregullorja synon të krijojë një kuadër të plotë dhe të qartë për studimet e ciklit të parë të studimit "Bachelor" në Matematikë, si dhe të përcaktoj rregulla standarte të përgatitjes, organizimit dhe administrimit të studentëve të këtij cikli.
 2. Kjo rregullore i bashkangjitet Rregullores së Brendshme të Departamentit të Matematikës dhe shtrin efektin e saj mbi njësinë mësimore – shkencore përgjegjëse për organizimin e programit të ciklit të parë në Matematikë.
- Ky programi i studim përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare dhe siguron Diplomë Universitare "Bachelor" në Matematikë.

**Neni 2
DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS**

Departamenti i Matematikës në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë(UV), është hapur në kuadrin e Fakultetit të Shkencave Teknike në vitin akademik 2008-2009 me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 832 datë 04.06.2008. Departamenti i Matematikës synon të ofrojë një formim akademik për të përgatitur profesionistët e ardhshëm të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin rajonal dhe kombëtar të vendit. Në sajë të bashkëpunimit me njësi të tjera të Universitetit tonë, organizata të ndryshme, Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, ne synojmë të përgatisim mësues të matematikës dhe specialistë, me sjellje dhe njohuri të denja për të konkuruar me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit.

**Neni 3
OBJEKTIVAT E DEPARTAMENTIT TË MATEMATIKËS**

Departamenti i Matematikës është një nga departamentet më të rëndësishëm në Fakultetin e Shkencave Teknike. Ai është njësi bazë mësimdhënëse/kërkimore me orientim profesional mësuesinë në Matematikë. Programet e ushtruara nga grupi mësimdhënës në departament janë: "Bachelor" në Matematikë, "Bachelor" në Matematikë-Financë, "Bachelor" në Shkencat Aktuaristike, "Master Profesional" në Matematikë, "Master i Shkencave" në Matematikë, "Master i Shkencave" në Matematikë – Financë, "Master i Shkencave" në Aktuaristikë, si dhe cikli i tretë i studimeve "Doktoratë" në Matematikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

Misioni i Departamentit të Matematikës është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të ofrojë dije përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Përmes programeve mësimore bashkëkohore, departamenti i matematikës synon të formojë specialistë të lartë në mësimdhënie dhe të përgatitë shkencëtarë të rinjë në fushat e matematikës, në përgjigje dhe në përshtatje me tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.

Vëmendje e veçantë i kushtohet përfshirjes në projekte kërkimore e fusha studimi me interes mesdhetar, evropian e më gjerë. Misioni i departamentit të Matematikës lidhet edhe me garantimin e cilësisë dhe sigurimin e standarteve akademike për të gjitha programet e studimit; me nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve dhe studentëve; ofrimin e mundësive për edukim gjatë gjithë jetës; kryerjes së shërbimeve ndaj të tretëve; bashkëpunimin me departamente të tjera brenda dhe jashtë vendit; ndërkombëtarizimin kryesisht përmes veprimtarisë shkencore, pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, mobiliteteve për stafin dhe studentët; përshtatjen e programeve ndaj kërkesave të kohës.

Neni 4

STRUKTURA E DEPARTAMENTIT

Si njësi bazë mësimore-kërkimore Departamenti është formatuar në përputhje me Nenin 25; kreu III të Ligjit Nr.80/ 2015 të Arsimit të Lartë. Elementët strukturorë të njësisë bazë janë: shefi i departamentit, anëtarët e përhershëm të tij, anëtarët e përkohshëm (të ftuar), grupet kërkimore-mësimore, këshilltari akademik, personeli ndihmës mësimor si dhe sekretarja e njësisë së Matematikës.

Njësitë përbërëse të Departamentit janë grupet mësimore të përhershme/të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor si vijon:

- Grupi i Algjebrës dhe Gjeometrisë Algjebrike* i cili përbëhet nga staf akademik që drejtimin e kualifikimeve të tyre "Master", "Doktoraturë" e kanë në algjebër dhe gjeometri dhe që zhvillojnë kërkim në disiplinat që bëjnë pjesë këtu;
- Grupi i Analizës, Ekuacioneve Diferenciale dhe Gjeometri* i cili përbëhet nga staf akademik që drejtimin e kualifikimeve të tyre Master, Doktoraturë e kanë në analizë dhe ekuacione diferenciale dhe që zhvillojnë kërkim në disiplinat që bëjnë pjesë këtu;
- Grupi i Probabilitet-Statistikës dhe Matematikës së Aplikuar*, i cili përbëhet nga staf akademik që drejtimin e kualifikimeve të tyre Master, Doktoraturë e kanë në probabilitet-statistikë dhe matematikë të aplikuar dhe që zhvillojnë kërkim në disiplinat që bëjnë pjesë këtu.

Neni 5

PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË

Përgjegjësi i Departamentit të Matematikës (njësisë bazë) është autoriteti drejtues akademik i njësisë ku dhe e përfaqëson atë. Ai zgjidhet me votim sipas udhëzimeve procedurale të vendosura në Ligjin e Arsimit të Lartë, ose emërohet nga Dekani pasi ky i fundit është këshilluar me personelin akademik. Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti më i lartë për departamentin. Detyrat dhe kompetencat e tij përcaktohen në Rregulloren e UV (2014), kreu III, neni 25. Përgjegjësi i Departamentit në veprimtarinë e tij mbështetet dhe përfaqëson mendimin e personelit akademik të departamentit. Veç detyrave të tjera të përcaktuara nga aktet normative në fuqi, përgjegjësi i departamentit ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- a. Drejton punën për hartimin e kurrikulave të programeve studimit që mbulon departamenti dhe ndjek me korrektësi zbatimin e tyre.
- b. Ndjek e kontrollon aktivitetin shkencor në departament, në përputhje me planifikimin vjetor dhe mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor e akademik të anëtarëve të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij.
- c. Harton orarin mësimor dhe bashkërendon shpërndarjen e ngarkesës mësimore në çdo formë të mësimdhënies midis personelit akademik të departamentit sipas rregulloreve e udhëzimeve përkatëse të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), dhetë Rektoratit, dhe ia përcjell atëpër miratim dekanit.
- d. I propozon dekanit masat për shkeljet e disiplinës në punë, të rregullave dhe standarteve akademike nga pedagogët.
- e. Organizon analizën vjetore të punës mësimore shkencore, analiza periodike ose analiza të tjera për raste e aspekte të veçanta në departament.
- f. Mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, të kërkimeve shkencore dhe të veprimtarive të tjera, në kohën e në mënyrën e caktuar.
- g. Mbikqyr dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik të departamentit.
- h. I paraqet dekanit listën me propozimet për personelin akademik të ftuar dhe atë me kontratë të përkohshme me kohë të plotë ose të pjesshme, pas miratimit paraprak në departament.
- i. Propozon Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike krijimin, ndryshimin apo shkrirjen e grupeve mësimore e kërkimore, strukturën e tyre dhe ndryshimet e saj në përputhje me Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- j. Mbikqyr respektimin e disiplinës në punë, merr masat përkatëse për rivendosjen e rregullit në raste shkeljesh apo të metash. Njofton dekanin dhe bën rekomandimet përkatëse për çështje organizative e disiplinore kur e çmon të arsyeshme.
- k. Ka të drejtë në çdo kohë, para fillimit të semestrit dhe gjatë semestrit, të bëjë çdo ndryshim në orarin mësimor, të riorganizojë apo zëvendësojë personelin akademik dhe të rishpërndajë ngarkesën mësimore në rast se konstaton shkelje të disiplinës në punë, të rregullave e standardeve akademike, moszbatim të urdhrave të autoriteve drejtuese në lidhje me procesin e mësimdhënies, abuzime apo performancë e dobët, apo kur vetë i konsideron të nevojshme këto ndryshime në funksion të menaxhimit me të mirë dhe sigurimit të standardeve të cilësisë dhe ia përcjell dekanit për miratim.

Neni 6

GRUPI KËRKIMOR MËSIMOR (GKM)

GKM është njësi akademike brenda Departamentit të Matematikës i përcaktuar në përputhje me specifikat e posaçme disiplinore apo natyrën e projekteve të ndërmarra. Përgjegjësi i grupit mësimor e kërkimor është drejtuesi i tij. Veç detyrave të tjera të përcaktuara nga aktet normative në fuqi, përgjegjësi i grupit mësimor e kërkimor ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij:

- a. Organizon hartimin e kurrikulave të disiplinave që mbulon grupi dhe i paraqet në departament për diskutim.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- b. Mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera.
- c. Ndjek aktivitetin shkencor të anëtarëve të grupit dhe për problemet që lindin, informon autoritetet drejtuese të departamentit.
- d. Raporton tek përgjegjësi i departamentit për realizimin e programit mësimor në përfundim të çdo semestri duke pasqyruar dhe mendimet e grupit mësimor kërkimor.
- e. Organizon analizën vjetore të punës dhe depoziton në departament dokumentacionin e aktivitetit shkencor të secilit anëtar.
- f. Mbikqyr dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore të grupit.
- g. Evidenton, verifikon dhe kur është rasti i propozon përgjegjësit të departamentit për shkeljet e disiplinës në punë nga punonjësit e grupit.
- h. Mbikqyr respektimin e disiplinës në punë, merr masat përkatëse për rivendosjen e rregullit në rast shkeljesh e të metash. Në rastet e rënda ose kur e çmon të arsyeshme, njofton përgjegjësin e departamentit me rekomandimet përkatëse organizative e disiplinore.

Neni 7

KËSHILLTARI AKADEMIK

Këshilltari Akademik përzgjidhet nga Përgjegjësi i Departamentit. Ai udhëzon e këshillon procesin akademik të studentëve, u përgjigjet nevojave për të ndjekur procedura të ndryshme akademike e administrative në respekt të të drejtave dhe përgjegjësi të organeve administrative përkatëse të UV, sipas përcaktimeve në nenin 85 të Rregullores (2014).

Neni 8

PERSONELI AKADEMIK – TË DREJTAT

Personeli i departamentit mund të përbëhet nga personeli akademik (me kohë të plotë të pacaktuar/ të caktuar, si dhe i ftuar), personeli ndihmës-akademik, personeli administrativ të cilët zhvillojnë veprimtari në departament.

Të drejtat e personelit akademik:

- a. Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ofron departamenti, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
- b. Të kërkojë të respektohen dhe të zbatohen të gjitha detyrimet që shtrohen gjatë procesit mësimor;
- c. Të kërkojë nga organet drejtuese të departamentit, respektimin prej tyre të të gjitha të drejtave që burojnë nga Kodi i Punës dhe ligji për arsimin e lartë;
- d. Të kërkojë nga studentët një frymë etiko-morale të tillë, që të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

DETYRAT E PERSONELIT AKADEMIK

- a. Të hartojë në kohën e duhur, programin mësimor të lëndës në përputhje me planin kalendar, tre kopje të të cilit dorëzohen në departament;
- b. Të shfrytëzojë me efektivitet orën e mësimit;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- c. Të ndjek sistematikisht zhvillimin dhe arritjet e shkencës përkatëse në plan kombëtar e botëror dhe ta reflektojë atë në procesin mësimor;
- d. Të hartojë në kohën e duhur tezat e provimit, të cilat çdo vit duhet të jenë të riformuluara e të përditesuara dhe gjithëpërfshirëse;
- e. Të zbatojë udhëzimet që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të programit mësimor;
- f. Të respektojë gjatë gjithë veprimtarisë së tij parimet e etikës qytetare, Kodin e Etikës të UV duke shfaqur një figurë të pajtueshme me veprimtarinë që zhvillohet në universitet;
- g. Të respektojë me përgjegjësi orarin dhe disiplinën në punë;
- h. Të ruajë sekretin profesional, të mos japë të dhëna lidhur me detyrën që kryen pa qenë i autorizuar nga autoriteti drejtues.

Neni 10

PËRGJEGJËSI TË TJERA TË PERSONELIT AKADEMIK

Përgjegjësitë e pedagogut përfshijnë ndër te tjera, por pa qenë të kufizuara, dhe përgjegjësi si më poshtë:

- a. Pedagogu duhet t'i zhvillojë orët e mësimit dhe provimet në orën dhe vendin e përcaktuar zyrtarisht.
- b. Çdo pedagog duhet të jetë në dispozicion në zyrën e vet në konsultim me studentët për një numër të arsyeshëm orësh çdo javë dhe duhet t'i bëjë të njohura këto orë.
- c. Pedagogu duhet të bëjë të njohur në fillim të çdo kursi objektivat dhe natyrën e kursit, datat e ngjarjeve të rëndësishme (p.sh. testime, detyra kursi), mënyra dhe sisteme të vlerësimit, frekuentimi i orëve të mësimit, provime, detyra dhe aktivizim në klasë.
- d. Pedagogu duhet të sigurohet që përmbajtja e kursit që ai jep të jetë në përputhje me përshkrimin e kursit në katalogun e universitetit.
- e. Pedagogu duhet të respektojë Rregulloren e Universitetit në lidhje me të drejtat e studentëve.
- f. Pedagogu duhet të frekuentojë takimet e detyruara nga procedurat e njësisë akademike në lidhje me ankesat e studentëve.
- g. Pedagogët duhet të mos përdorin auditorin me studentë për veprimtari që nuk lidhen me mësimdhënien dhe të mos përcjellin mesazhe personale për kolegët dhe autoritetet drejtuese.

Neni 11

MASAT DISIPLINORE PËR PERSONELIN AKADEMIK

Përgjegjësi i Departamentit, ka të drejtë të propozojë masa disiplinore për personelin akademik, personelin ndihmës-mësimor shkencor dhe administrativ në Departamentin e Matematikës sipas akteve normative në fuqi. Këto masa ai i propozon tek dekani dhe në rast mospërputhje, drejtpërdrejt te Rektori.

Neni 12

PRANIMI I STUDENTËVE

Pranimi i studentëve në UV, realizohet bazuar në nenin 74, 76 dhe 78 të Ligjit Nr. 80/2015, "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" si



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

dhe në vetë kriteret e parashikuara në nenin 25 dhe nenin 39 të rregullores së UV si dhe në kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga SA i Institucionit.

Neni 13 ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Programi i studimit "Bachelor" në Matematikë siguron Diplomë Universitare "Bachelor" në Matematikë. Ky program organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Për të fituar këtë diplomë nevojiten 180 kredite (ECTS). 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh.

1. Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra dhe shtrihet në intervalin nga 30 deri 40 javë mësimore, sipas udhëzimeve MASR (30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe provim formimi / mbrojtje teze diplome). Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me Udhëzim të MASR në çdo fillim viti akademik.
2. Çdo semestër zgjat 15 javë për mësim dhe mesatarisht 3-4 javë për provime. Datat e sakta të kohëzgjatjes së mësimit, pushimeve dhe provimeve përcaktohen dhe shpallen nga Departamenti dhe janë të parashikuara në Strukturën e Vitit Akademik.
3. Me fillimin e vitit akademik, Departamenti shpall orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për semestrin përkatës.
4. Moduli themelor i studimit është lënda semestrale me kredite (ECTS) të bashkangjitura në planin mësimor të miratuar të programit të studimit.
5. Numri i caktuar i kredive fitohet pas përfundimit me sukses të disiplinës, siç është përshkruar në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
6. Vlerësimi i studentëve bëhet nga personeli akademik përkatës që zhvillon disiplinën mësimore, i cili detyrohet të organizojë sipas gjykimit të tij kontrole me gojë, me shkrim, detyra të pavarura, detyra kursi etj. Në përputhje me mënyrat e vlerësimit të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
7. Studenti përfundon studimet në këtë program studimi dhe merr diplomë kur ka likujduar me sukses gjithë disiplinën mësimore të parashikuara në planin mësimor përkatës, ka mbrojtur me sukses tezën e diplomes / provimin e formimit, kjo në varësi të notës mesatare që arrin studentin gjatë tre viteve të studimit, dhe ka fituar 180 kredite (ECTS). Këto dy forma vlerësimi përmbajnë tematikën të lëndëve të drejtimit që ka ndjekur në program, me qëllim krijimin dhe vlerësimin e dijeve të fituara në disipinën të ndryshme.

a. **Tematika e temës së diplomës**

Teza e diplomës mund të jetë bibliografike, kërkimore apo dhe kombinim i të dyjave për çështje që lidhen me disiplinën mësimore të planit mësimor të programit të studimit. Një student mund të propozojë vetë një temë diplome dhe ta hartojë atë me kushtin që të marrë miratimin e pedagogut udhëheqës. Teza e diplomës duhet të jetë personale. Aprovimi i temës dhe udhëheqësit bëhet nga Departamenti.

b. **Forma dhe vëllimi i tezes së diplomës.**

Teza e diplomës nuk mund të kalojë 12 000 fjalët (afërsisht 40 faqe) dhe struktura e saj duhet të jetë në përputhje me rregullat e një punimi shkencor. Format i saj është standart dhe aprovohet nga Departamenti.

c. **Diagrama kohore**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

E shumta 1 muaj përpara mbarimit të semestrit të parë të vitit akademik pedagogët janë të detyruar të shpallin me shkrim studentëve propozime temash për tezat e diplomave. Me fillimin e semestrit të dytë, studentët zgjedhin temën dhe në marrëveshje me udhëheqësin marrin përsipër tezën e diplomës dhe dorëzojnë një Deklaratë të marrjes së Tezës së Diplomës. Koha minimale e dorëzimit të Tezës së Diplomës nuk mund të jetë më e vogël se 8 javë pas marrjes përsipër të saj dhe e detyruar përpara fillimit të sezonit përkatës të provimeve të verës apo të vjeshtës.

d. **Detyrime të pedagogut udhëheqës**

- Shpallja në kohë e propozimeve për tema diplomash që dëshirojnë dhe mund të udhëheqin.
- Udhëheqje dhe takime këshilluese në periudha të rregullta kohore me studentët. T'u ofrojë studentëve udhëzime për shkrimin dhe mbrojtjen e temës si dhe për vlerësimin e saj.
- Çdo pedagog mund të udhëheqë deri në tre tema diplomash njëherësh.

e. **Vlerësimi**

Tema e diplomës vlerësohet me sistemin prejdhjetë notash përpara një komisioni të ngritur në Departament.

8. Koha minimale për të përfunduar studimet në programin e studimeve Matematikë është 3 vjet. Studenti fillon studimet me atë plan mësimor që i është bërë e njohur atij në ditën e regjistrimit në sekretarinë e fakultetit, gjithmonë në qoftë se i kryen detyrimet në kohën minimale të parashikuar për përfundimin e studimeve në kete program studimi. Në të kundërt ai u nënshtrohet detyrimeve të reja që lindin.
9. Kohëzgjatja e orës së mësimi është 50 minuta.

Neni 14

NDËRPRERJA E STUDIMIT

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

- Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjeko-ligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi (jo nga mjeku i familjes).
- Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat përkatëse.

Në çdo rast dokumentat duhet të paraqiten përpara se të ndërpresë studimet, të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit. Për studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra radhë dhe nuk kanë marrë lejen nga rektori për këtë ndërprerje duhet të aplikojnë përsëri për praninë në universitet.

Neni 15

NJOHJA, EKUIVALENTIMI DHE TRANSFERIMI

Është e mundur njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë universitetit. Pranë Departamentit ngrihet Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit i cili vlerëson dokumentacionin e studentit të përcjellë nga Zyra e Regjistrimit dhe bën njohjen e krediteve përkatëse për disiplinat mësimore të llikuadurara të cilat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

mbulojnë të paktën 80% të programit të disiplinës mësimore për të cilën kërkohet njohja e krediteve. Numri maksimal i krediteve që mund ti njihen një studenti të transferuar nga një program tjetër studimi është 60 kredite. Modalitetet dhe procedurat për transferimin e studentëve janë të përcaktuara në Kreun VI të Rregullores së Brendshme të Universitetit.

Neni 16

FREKUENTIMI DHE DETYRIMET NË PROVIM

- Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%.
- Numri i mungesave të lejuara përlllogaritet për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që i takojnë provimeve të pjesshme.
- Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkatës i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin.
- Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin (jo më pak se 75 % frekuentim), atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale.
- Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.
- Sekretaritet mësimore përgjigjen për administrimin e informacionit mbi frekuentimin e studentëve.

Neni 17

TË DREJTAT E STUDENTËVE

Të drejtat dhe obligimet e studentëve janë të parashikuara në nenin 70 të Rregullores së UV, 2014, ndërsa shkeljet disiplinore nga studentët parashikohen në nenin 74 të po kësaj rregulloreje.

Studenti ka të drejtë:

- Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij.
- Të përdorë pajisjet, bazën materiale dhe laboratorike të universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit.
- Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, si në Senatin Akademik, në Këshillin e Administrimit, ku janë të regjistruar, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit.
- Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- e. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare.
- f. Të përfitojë shpërblime të veçanta që akordohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë sipas ligjit dhe kriterëve të caktuar nga Senati Akademik.
- g. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit
- h. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, mosrealizimine procesit të mësimdhënies, rregullat për zhvillimineprovimit dhe për vlerësimin e tij të pamerituar.
- i. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që cënon integritetin e studentit.
- j. Të ndjekë studimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e Senatit apo në aktet e posaçme të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Të drejta të tjera të studenteve janë përcaktuar në Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin (2013) dhe në Rregulloren (2014) të UV.

**Neni 18
OBLIGIMET E STUDENTËVE**

Studenti është i detyruar:

- a. Të njohë me hollësi Statutin, Rregulloren e Universitetit dhe çdo Rregullore tjetër e detyrimet që lindin për të dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- b. Të njohin të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë;
- c. Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, nga kjo rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë.
- d. Të respektojë Kodin e Etikës së universitetit.
- e. Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në programin e studimit si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material ndaj universitetit.
- f. Të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të parashikuara në ligj.
- g. Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tij; dëmet materiale që ai mund të ketë bërë zhdëmtohen në masën e përlogaritur.

Detyra apo përgjegjësi të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin (2013) dhe në Rregulloren (2014) të UV.

**Neni 19
PËRGJEGJËSI TË TJERA TË STUDENTËVE**

Përgjegjësitë e studentit përfshijnë ndër të tjera edhe pikat më poshtë:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

- Studenti duhet të dijë dhe të zbatojë politikat e pedagogut në lidhje me frekuentimin, testimet, detyrat e kursit dhe aktivizimin në klasë.
- Studenti duhet t'i drejtojë ankesat akademike në lidhje me një orë mësimi në kanalet e sipërpërmendura.
- Me kërkesën e pedagogut të vet, studenti duhet të konsultohet me pedagogun në një kohë të përshtatshme për të dyja palët.
- Studenti duhet të marrë pjesë në takimet e detyruara nga procedurat e njësive akademike në lidhje me ankesat.

Neni 20

MASAT DISIPLINORE PËR STUDENTËT

Shkelje e rregullave të universitetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cënojnë personalitetin e personelit akademik, të çdo punonjësi tjetër të universitetit dhe cdo studenti, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, fyerjet, sharjet, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj., kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- Vërejtje me shkrim;
- Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti;
- Pezullimin nga universiteti për një semester ose një vit;
- Përjashtim nga universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;
- Përjashtim përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Vendimin për "Vërejtje me shkrim", "Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti" dhe "Pezullim nga universiteti për një semester ose një vit" e merr dekanati përkatës. Në raste të veçanta të parashikuara në Kodin e Etikës këto vendime mund të merren nga Rektorati.

Vendimin për "Përjashtimin nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë" (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe "Përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë" (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasshme) e merr Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, mbi bazën e propozimit të dekanatit përkatës.


Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e tre muajve për vërejtjen, brenda 6-muajve për paralajmërimin dhe një viti për pezullimin.

Neni 21

KONTROLLI I DIJEVE – ADMINISTRIMI I PROVIMIT

A) Kontrolli i dijeve: Mbështetet në nenet 60 – 65 të Rregullores së UV.

- Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor.
- Kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi të pjesshëm, një provimi final gjithpërfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës.
- Pesha (përqindja) e provimit të pjesshëm, të jetë nga 25-30% e vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet jo më larg se java e shtatë, ndërsa 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, mund të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, të gjitha së bashku.

- d. Orari i provimeve finale duhet të shpallet para përfundimit të semestrit.
- e. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final.
- f. Në rastin kur studenti nuk merr pjese në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr dekani i fakultetit, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga studenti.
- g. Studentët merren në provim nga pedagogu i lëndës. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës. Afati për hedhjen e rezultateve në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Univlora (SMI-Univlora) brenda 48 orë.
- h. Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Përgjegjësit të Departamentit.
- i. Kur studenti në provim vlerësohet me notën 4 (katër) ose "NP" (Nuk u paraqit), ai ka të drejtën të regjistrohet për të shlyer këtë lëndë vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve në dimër dhe në një semestër tjetër.
- j. Studentët e ciklit të parë kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik.
- k. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktura nga dekani i fakultetit para mbrojtjes së diplomës, kundrejt një tarife të miratuar.

B) Administrimi i dokumentacionit

- a. Në fund të çdo provimi, testet dhe çdo material i provimit dorëzohet në sekretarinë e departamentit përkatës, mbyllet në një zarf mbi të cilin të jenë shkruar të gjitha të dhënat e nevojshme dhe firmoset nga lektori.
- b. Zarfet me testet e provimeve të arkivuara në sekretarinë e departamentit, mund të hapen dhe të kontrollohen vetëm në rast ankimi ose shihet e arsyeshme nga autoritetet drejtuese. Këto materiale ruhen deri në fund të provimeve të semestrit pasardhës e më pas ato digjien.
- c. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, me përjashtim të Përgjegjësit të Departamentit, autoriteteve drejtuese të fakultetit e personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll.
- d. Departamenti i Matematikës mund të propozojë ndërtimin e një Komisioni për mbikqyrjen e procesit të provimeve.

Neni 22

SEKRETARIA E DEPARTAMENTIT

- a. Sekretaria mësimore e Departamentit të Matematikës është e detyruar të mbajë regjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore.
- b. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

përhershme. Sekretaria mësimore e çdo fakulteti apo departamenti përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar (bazë) të shkruar me dorë dhe me kompjuter. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye.

- c. Në sekretarinë mësimore depozitohen të firmosura nga anëtarët e personelit akademik në kohën e duhur lista e studenteve të regjistruar në kursin përkatës e ndarë në leksione dhe seminare me informacionin për mungesat si dhe proces-verbalet e vleresimeve në provimet e pjesshme dhe përfundimtare të kurseve, dhe cdo informacion tjetër që kërkohej për të konfirmuar realizimin e procesit të mësimdhënies, i firmosur ky i fundit nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i fakultetit.
- d. Sekretaret mësimore mbajnë edhe detyrën e sekretares së departamentit dhe ndër të tjera kanë për detyrë të informojnë me shkrim për çdo çështje apo problem, sa herë që iu kërkohej me një urdhër me shkrim ose me gojë, nga autoritet drejtuese të çdo niveli.
- e. Cdo komunikim me pedagogun gjatë vitit akademik apo gjatë sesionit të provimeve bëhet nëpërmjet sekretares përkatëse.

Neni 23

FORMAT E KOMUNIKIMIT DHE TË NJOFTIMIT

Bazuar në rregulloren e UV format e komunikimit do të jenë si më poshtë:

- a. Drejtuesi dhe anëtarët e njësisë bazë mësimore-kërkimore të departamentit Të Matematikës marrin dijeni për aktet ligjore e nënligjore, apo aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tyre, nga struktura vartëse.
- b. Dorëzimi apo njoftimi mbi aktet të protokolluara u bëhet anëtarëve të organeve drejtuese dhe autoriteteve drejtuese apo gjithë personelit të departamentit kur kjo është e nevojshme, përkundëjt nënshkrimit të drejtpërdrejtë apo të bashkëlidhur të tekstit përkatës, i cili ruhet nga komunikuesi, për aq kohë sa ka fuqi vepruese akti. Më pas akti arkivohet.
- c. Komunikimi i mësipërm dhe njoftimet e çdo lloji drejtuar personelit akademik, është i vlefshëm dhe konsiderohet i kryer edhe kur bëhet nëpërmjet postës elektronike zyrtare, ose publikimit në faqen zyrtare të internetit www.univlora.edu.al, ose njoftimit verbal nga autoritet drejtuese të çdo niveli apo nga personat e caktuar prej tyre për të bërë njoftimin.
- d. Nga ana e personelit akademik dhe joakademik, komunikimi nëpërmjet postës elektronike zyrtare nuk përdoret për çdo arsye dhe në çdo kohë.
- e. Përgjigjet zyrtare, të cilat duhen bërë vetëm përmes shkresave zyrtare, nuk mund të zëvendësohen me kthim përgjigje përmes përdorimit të postës elektronike zyrtare në asnjë rast.
- f. Komunikimi do të bëhet nëpërmjet përgjegjësit të njësisë bazë të matematikës, grupit kërkimor sekretares apo personit të autorizuar.

Mosrespektimi i këtij neni, përbën shkelje dhe merren masa disiplinore referuar nenit 50 të Statutit dhe nenit 34 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 24

RREGULLAT E SJELLJES AKADEMIKE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

- Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.
- Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër duke i konsideruar ato te veta.
- Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

Pedagogët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

- Të informojnë dhe të udhëzojnë studentët mbi procedurat dhe standartet e punës kërkimore, si dhe mbi dokumentacionin e kërkuar për të kryer detyra në një kurs të caktuar apo në kontekstin e një disipline të caktuar.
- Të ndërmarrin hapa konkretë për të dalluar dhe parandaluar mashtrimin.
- Të raportojnë sjelljen akademike të dyshuar si jo të nderhme tek dekani për t'u konsideruar me tej nga Zyra Akademike.
- Të paraqesin evidencë të plagjiaturës, të mashtrimit në provime apo raporte laborator, të falsifikimeve të dokumentave apo të tjera forma sjelljeje të pandershme akademike pranë Zyrës Akademike.

Studentët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

- Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
- Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.
- Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.
- Të evitojnë aparençën e mashtrimit (të lënit përshtypje sikur po mashtrojnë). Nëse studentët janë të bindur që praktikat e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'ia përcjellin këtë mesazh Përgjegjësit të Departamentit, Dekanit ose t'i drejtohen me ankese të drejtëpërdrejtë Rektorit. Raste të tilla do të gjykohen dhe vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi.

Neni 25

NORMA TË ETIKËS GJATË KOMUNIKIMIT PERSONEL AKADEMIK-STUDENT

Gjatë veprimtarisë së mësimdhënies shpesh vihen re problematika rreth koordinimit të punës së stafit me studentët. Për këtë qëllim kjo Rregullore sugjeron të ndiqen disa udhëzime praktike të miratuara si më poshtë:

- Studenti është i detyruar të zbatojë e respektojë Kodin e Etikës të miratuar në UV.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- b) Kontakti i pedagogut me studentin për aspekte të mësimdhënies apo kërkimit shkencor do të bëhet vetëm në ambientet e auditoreve, laboreve dhe në asnjë rast jashtë tij.
- c) Komunikimi me studentin mund të bëhet në rrugë elektronike në adresën e pedagogut e cila është regjistruar më parë në departament.
- d) Justifikimet nga ana e studentëve tek pedagogu për mungesat gjatë vitit pranohen vetëm pas dorëzimit të raporteve të marrë nga komisione të posacëm.
- e) Në rast të vonësive të pedagogut në auditor studentit duhet të presë disa minuta dhe nëse pedagogu nuk ka njoftuar paraprakisht ai mund të largohet.
- f) Në auditor, laboratorë si dhe gjatë provimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve të komunikimit.
- g) Në ditën e provimit studentit respekton me përpikmëri datën, vendin e provimit, si dhe siguron mjetet e nevojshme (stilolaps, makinë llogaritëse, mjet identifikimi).
- h) Në ambjentet e provimit nuk lejohet prania e familjarëve të studentit përveçse personave të autorizuar nga ana e Përgjegjësit të Departamentit (pedagogë, sekretare).
- i) Pedagogu ju'a komunikon notën studentëve (në mungesë të sistemit) ose bën verifikime të vlerësimit në një orar e sallë të caktuar e jo në katedër.
- j) Për komunikime të pedagogut me studentët që kanë tema diplome hartohet një grafik i konsultimit në një sallë e ditë të caktuar javore.

**Neni 26
ÇËSHTJE AKADEMIKE**


Çdo njësi akademike duhet të respektojë procedurat për zgjidhjen e ankesave, në lidhje me vlerësimin, standartin dhe cilësinë e mësimdhënies, situatat brenda në klasë dhe çdo problem tjetër akademik. Për rastet e ankesave në lidhje me vlerësimin, ndiqet ajo procedurë e përcaktuar në nenin 62 të rregullores së UV.

**Neni 27
ÇËSHTJE JOAKADEMIKE**

Personeli i universitetit dhe studentët mund të hasin situata problematike gjatë kohës së punës apo të studimeve në universitetin "Ismail Qemali" Vlorë në të cilat mund të përfshihen rastet e fyerjeve, sharjeve, konfrontimeve fizike. Qëndrimi diskriminues apo ngacmimi seksual, sharjet apo fyerjet raciale, sharjet për orientimin seksual, për ngjyrën, fenë, bindjet, origjinën kombëtare apo prejardhjen, gjendjen martesore, gjendjen familjare etj., kërkojnë vëmendje të veçantë në zgjidhjen e tyre.

**Neni 28
MJEDISËT E PUNËS DHE SIGURIA**

Personeli mësimdhënës si dhe personeli mbështetës pranë Departamentit të Matematikës kanë të drejtë të shfrytëzojnë mjediset e vëna në dispozicion për mësimdhënie (salla) si dhe bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Teknike si dhe bibliotekën e UV. Gjatë përdorimit të mjedisit të punës është detyrim institucional shfrytëzimi racional dhe ruajtja e mjeteve dhe pajisjeve si dokumentacion (tekste, tema diplomash, manuale etj.), pajisje TIK, aksesore të ndryshme, mjete demonstrimi, mjete praktike etj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**Neni 29
BIBLIOTEKA**

Stafi mësimdhënës si dhe ai studentor kanë të drejtë të shfrytëzojnë Bibliotekën e Fakultetit dhe Universitetit (edhe atë virtuale) për qëllime mësimore edukative, kërkimore si dhe gjatë angazhimeve të projekteve të përbashkëta të planifikuara si bashkëpunime me të tretët pas miratimit të Kryetarit të Grupit Kërkimor si dhe Përgjegjësve të njësisë bazë e qëndrore.

**Neni 30
PROMOVIMI I VLERAVE TË DEPARTAMENTIT**

Si një departament i ri Departamenti i Matematikës ka njohur rritje në drejtim të strukturimit të tij, arritjeve akademike-shkencore si dhe tendencës për të qenë një njësi që konkuron me vlera në sfidën e formimit e të kualifikimit të intelektualëve në disiplinën e Matematikës. Në përputhje dhe me strategjinë e UV për promovimin e vlerave të tij, Departamenti ka për detyrim:

- Të jetë pjesë e promovimit të vlerave të tij universitare gjatë panairëve të organizuara nga institucione në rang vendi.
- Të mbështesë studentët ekselentë në ceremonitë e zhvilluara nga UV si dhe të bashkëpunojë me ta për promovuar vlerat e tyre më tej.

Të bëhet pjesë e politikës informuese (kontakte të drejtpërdrejta, media, broshura informuese etj.) në institucione parauniversitare në përputhje kjo dhe me strategjinë e UV, me qëllim prezantimin e platformës së Departamentit për tërheqjen e maturantëve në vitin pasardhës.

**Neni 31
DISPOZITA TË FUNDIT**

Çdo çështje që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e Brendshme të Universitetit. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë Departamenti i propozon Rektorit dhe Senatit Akademik propozimin përkatës për miratim.



Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skele



Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al